



ZERI I POPULLIT

ORGAN I KOMITETIT QENDROR TE PPSH

Viti i 43-të i botimit
Nr. 87 (11.457)

E premte, 12 prill 1985

Çmimi 30 qindarka

DHIMBJE E THELLE PER PARTINE E GJITHE POPULLIN SHQIPTAR

VDIQ UDHEHEQESI YNE I DASHUR SHOKU ENVER HOXHA

Shokë, komunistë, punëtorë, kooperativistë, intelektualë, gra e të rinj të Shqipërisë, veteranë të luftës e bashkatdhetarë.

Me hidhërim e dhimbje të thellë ju njoftojmë se sot, më 11 prill 1985, ora 2.15, pushoi së rrahuri zemra e Udhëheqësit të dashur e të lavdishëm të Partisë dhe të popullit tonë shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë, Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të RPS të Shqipërisë.

U nda prej nesh themeluesi i Partisë sonë të lavdishme, organizatori dhe udhëheqësi i Luftës Nacionalçlirimtare e i revolucionit tonë popullor, arkitekti i ndërtimit të Shqipërisë së re socialiste. Mbylli sytë Komandanti heroik i Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, Ai që krijoi Frontin Demokratik dhe hodhi themelet e Pushtetit Popullor.

Jeta dhe Vepra e Enver Hoxhës, është historia e gjallë e Shqipërisë së sotme. Emri i Tij është i lidhur me të gjitha betejat klasore dhe me të gjitha fitoret e Partisë e të popullit shqiptar. Në të gjitha etapën që ka kaluar populli ynë, që nga dita kur u krijua Partia Komuniste e deri më sot, në çdo kohë kur vendoseshin fatet e popullit e të Atdheut, kurdoherë ka qenë i pranishëm mendimi dhe personaliteti i Tij. Në të gjitha momentet kyçe kur zgjidhej rruga që duhej ndjekur e lufta që duhej zhvilluar, udhëheqja dhe drejtimi i Tij kanë qenë vendimtare.

Revolucionar i bindur e patriot i devotshëm, Enver Hoxha ishte i pari ndër komunistët shqiptarë që kuptoi nevojën e madhe historike të krijimit të Partisë Komuniste, të shtabit të vetëm e të aftë për të bashkuar popullin e për ta udhëhequr në luftën për çlirimin e Shqipërisë dhe vendosjen e pushtetit popullor. Atij i takon merita e madhe historike që në momentet më të rënda të pushtimit, të shtypjes fashiste dhe të tradhtisë kombëtare të forcave të vjetra politike, e krijoi këtë shtab, e fuqizoi organizativisht dhe e edukoi ideologjikisht. Ishte Ai në krye të Partisë që në përpjekje të ashpër me armiq të jashtëm e të brendshëm, me oportunistët e fraksionistët, hartoi dhe përpunoi vijën e përgjithshme politike të Luftës Nacionalçlirimtare, që gjeti e përcaktoi rrugët për të arritur në fitoren e 29 Nëntorit 1944.

Nën udhëheqjen e shokut Enver Hoxha Partia realizoi bashkimin e popullit shqiptar në Frontin Nacionalçlirimtar. Ai ishte iniciatori dhe organizatori i Konferencës historike të Pezës. Për herë të parë populli ynë arriti unitetin luftarak mbi bazën e një platforme që shprehte dëshirat dhe aspiratat e vërteta kombëtare të tij. Ishte ky unitet që u bëri ballë forcave të egra të pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit.

Shoku Enver Hoxha është organizatori i drejtpërdrejtë i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Nën komandën e Tij partizanët tanë të lavdishëm luftuan me heroizëm të pasqor brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë dhe me mbështetjen e forcave patriotike të gjithë popullit çliruan Atdheun tonë të dashur.

Krijimi i Pushtetit Popullor dhe i shtetit të ri shqiptar që lindën në zjarrin e Luftës Nacionalçlirimtare kanë në themelet e tyre mendimin revolucionar dhe veprimtarinë udhëheqëse të shokut Enver Hoxha. Nën kujdesin dhe sipas mësimave të Tij, këshillat popullorë u bënë arma e fuqishme e diktatorit të proletariatit, e demokracisë së masave, dhe e ndërtimit socialist.

Shoku Enver Hoxha hartoi e përpunoi programin e transformimeve madhështore dhe të ndërtimit të shoqërisë së re socialiste. Nën udhëheqjen e komunistëve e me shokun Enver në krye u zhvilluan betejat fitimtare për industrializimin, ndërtimi i gjithë atyre veprave monumentale që i dhanë vendit klasën e re punëtorë dhe një bazë të fuqishme për zhvillimin e gjithanshëm ekonomik e shoqëror.

I mbështetur në marksizëm-leninizmin dhe njohës i vuajtjeve e aspiratave shekullore të fshatarësisë sonë patriote, shoku Enver Hoxha dha orientimet themelore për kolektivizimin e modernizimin e bujqësisë. Në realitetin e sotëm të fshatit kooperativist duket qartë drejtësia e rrugës që përcaktoi Partia.

Shoku Enver Hoxha e udhëhoqi Partinë dhe popullin në realizimin e revolucionit të thellë ideologjik e kulturor që është kryer tek ne. Në qoftë se Shqipëria është sot një vend i përparuar socialist e që zhvillohet me forcat e veta, atdhe i njerëzve të lirë nga çdo shtypje sociale e shpirtërore, vend i demokracisë dhe i mirëqënies për të gjithë, i arsimit dhe kulturës për

masat e gjëra të popullit, kjo i detyrohet luftës që ka bërë populli shqiptar me Partinë e shokut Enver Hoxha në krye.

Nuk ka fushë të aktivitetit politik, ideologjik e shoqëror të Partisë dhe të shtetit tonë ku të mos jetë shprehur mendimi filozofik, forca organizative dhe veprimtaria udhëheqëse e shokut Enver Hoxha. Ai ka përpunuar vijën e përgjithshme të politikës së jashtme dhe qëndrimet e Partisë e të shtetit tonë për çështjet ndërkombëtare. Kjo politikë, kundërshtimi i vendosur i imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik dhe reaksionit botëror, e përkrahjes së singertë të luftërave revolucionare e çlirimtare të popujve, e solidaritetit me forcat demokratike e antiimperialiste, i ka forcuar pozitën ndërkombëtare të vendit tonë, ka rritur simpatinë e respektin për Shqipërinë socialiste në botë, ka shtuar miqtë e dashamirësit e saj.

Nën udhëheqjen e shokut Enver Hoxha Partia e Punës e Shqipërisë ka zhvilluar një luftë heroike kundër revizionizmit modern. Askush si Ai nuk ka mbrojtur me aq pathos revolucionar, në çdo kohë e në çdo situatë, mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit nga shtrembërimet oportuniste, askush si Ai nuk ka demaskuar politikën dhe veprimtarinë socialimperialiste e socialshoviniste të titistëve, hrushovianëve e rënegatëve të tjerë.

Askush si Ai nuk ka luftuar me aq forcë e vendosmëri kundër armiqve të brendshëm të Partisë, grupeve fraksioniste dhe agjentëve të huaj që nga Koçi Xoxe e deri te banda e Mehmet Shehut. Kjo luftë ka qenë shpëtimtare për Partinë, popullin dhe Atdheun tonë.

Shoku Enver Hoxha radhitet ndër ata revolucionarë të shquar që kanë dhënë një kontribut të madh e të veçantë në zhvillimin e mendimit teorik marksist-leninist, që prek të gjitha çështjet e revolucionit dhe të ndërtimit të socializmit. Përgjithësimet e përvojës së luftës çlirimtare dhe të praktikës së ndërtimit të shoqërisë sonë të re, analizat e konkluzionet mbi proceset e zhvillimit të sotëm botëror, janë me një vlerë të madhe ideore, pika orientimi e referimi për veprimtarinë e përditshme revolucionare.

Si internacionalist i vërtetë, Ai ka përkrahur pa u lodhur parti të e reja marksiste-leniniste dhe luftën e tyre revolucionare, u ka qenë kurdoherë afër dhe ka ndjekur me vëmendje luftën për konsolidimin e përparimin e tyre.

Shoku Enver Hoxha është figura më e madhe historike e popullit dhe kombit tonë që do t'u ndrisë me shkëlqim të pashuar rrugën brezave të tashmë dhe të atyre që do të vijnë. Ai do rrojë përjetë i dashur, i nderuar dhe i respektuar në zemrat e gjithë komunistëve dhe të popullit tonë. Me Veprën dhe mësimet e Tij do të jetë kurdoherë pranë tyre për t'i frymëzuar në luftë dhe në punë për të mirën e atdheut dhe të komunizmit.

Le të mbetet flamur lufte thirrja e Tij e zjarrtë drejtuar popullit shqiptar me rastin e 40-vjetorit të çlirimit të Atdheut:

«Ta ruajmë si sytë e ballit gjithëkemi arrihur, ta zhvillojmë me konsekuencë më tej, t'u lejmë brezave të ardhshëm një Shqipëri kurdoherë e më të fortë, kurdoherë të kuqe, si flakë e pashuar e zemrave dhe idealeve komuniste e partizanë, një Shqipëri që të rrojë e të përparojë në shekuj. Jam i bindur se populli e Partia lart e më lart do ta mbajnë flamurin tonë fitimtar, lart e më lart do ta ngrënë nderin, prestigjin dhe emrin e Shqipërisë socialiste në botë».

Ky është edhe betimi i njëzëshëm që bën sot Partia jonë e Punës dhe mbarë populli shqiptar.

Në këto çaste të dhimbjes së thellë për humbjen e Udhëheqësit, shokut e mësuesit tonë të shtrenjtë, Enver Hoxha, le të forcojmë unitetin tonë të çelikut dhe t'i shtrëngojmë edhe më fort radhët rreth Partisë e Komitetit të saj Qendror, le të mobilizojmë edhe më tepër forcat tona për ta bërë Shqipërinë tonë ashtu siç e donte shoku Enver, të fuqishme, të begatë e të përparuar, le të punojmë pa u lodhur siç punoi e luftoi Ai për gjysmë shekulli me radhë për ta ngritur edhe më lart emrin e saj.

Lavdi Veprës së ndritur e të pavdekshme të shokut Enver Hoxha!

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË
PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
KËSHILLI I PËRGJITHSHËM I FRONTIT DEMOKRATIK TË SHQIPËRISË

Tiranë, më 11 prill 1985

Jeta dhe vepra e shokut Enver Hoxha është historia e gjallë e Shqipërisë së sotme. Emri i Tij është i lidhur me të gjitha betejat klasore dhe me të gjitha fitoret e Partisë e të popullit shqiptar.



Vendim mbi krijimin e komisionit për organizimin e varrimit të shokut Enver Hoxha

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Këshilli i Përgjithshëm i Frontit Demokratik të Shqipërisë, Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i përbërë nga shokët: Ramiz Alia kryetar, Adil Çarçani, Hajredin Çeliku, Hekuran Isai, Lenka Çuko, Manush Myftiu, Muho Asllani, Pali Miska, Rita Marko, Simon Stefani, Besnik Bekteshi, Foto Çami, Llambi Gegprifti, Prokop Murra, Qirjako Mihal, Haki Toska, Shefqet Peçi, Spiro Koleka, Xhafer Spahiu, Pilo Peristeri anëtarë.

Vendosën:

Të krijohet komisioni për organizimin e varrimit të shokut Enver Hoxha, Udhëheqës i shquar i Partisë dhe i popullit shqiptar, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë, Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i përbërë nga shokët: Ramiz Alia kryetar, Adil Çarçani, Hajredin Çeliku, Hekuran Isai, Lenka Çuko, Manush Myftiu, Muho Asllani, Pali Miska, Rita Marko, Simon Stefani, Besnik Bekteshi, Foto Çami, Llambi Gegprifti, Prokop Murra, Qirjako Mihal, Haki Toska, Shefqet Peçi, Spiro Koleka, Xhafer Spahiu, Pilo Peristeri anëtarë.

Tiranë, më 11 prill 1985

KOMUNIKATE MJEKESORE

Shoku Enver Hoxha vuante që prej vitit 1948 nga sëmundja diabeti i sheqerit, e cila me kalimin e kohës shkaktoi dëmtime të përhapura të enëve të gjakut, të zemrës, të veshkave dhe të disa organeve të tjera.

Në vitin 1973, si rrjedhojë e këtyre dëmtimeve, kaloi infarkt miokardi me çrregullime të ritmit. Në vitet e mëpasme u zhvillua insuficienca e rëndë e zemrës.

Para një viti pësoi insult iskemik të trurit me hemiparezë kalimtare.

Në mëngjesin e datës 9 prill 1985 bëri ndalim të papritur zemre nga fibrilacioni ventrikular. Megjithatë mjekimin intensiv, ripërsëritja e fibrilacioneve ventrikulare dhe pasojat e parikthyeshme në tru e në veshka shkaktuan vdekjen në ora 02.15 të datës 11 prill 1985.

Ekipi mjekësor:

Profesor Petrit Gace, Profesor Fejzi Hoxha, Kandidat i shkencave mjekësore Isuf Kalo, Docent Ylli Popa, Profesor Bajram Preza, Doktor Ahmet Kamberi, Kandidat i shkencave mjekësore Sabit Broka, Doktor Arben Fino.

Tiranë, më 11 prill 1985

SHOKU ENVER HOXHA DO TE RROJE PERJETE I DASHUR, I NDERUAR DHE I RESPEKTUAR NE ZEMRAT E GJITHE KOMUNISTEVE DHE TE POPULLIT TONE

TIRANE

Një familje e madhe, me një dhimbje të madhe

Si një familje e madhe e njerëzve tanë, me një dhimbje shumë të madhe, ishte dje Tirana. - kryeqyteti i Shqipërisë sonë socialiste. Njerëzit e saj, komunistë, veteranë e të rinj, punëtorë e kooperativistë, ushtarakë e nxënës, shkencëtarë e shkrimtarë, me lot në sy, qëndronin të grumbulluar nëpër qendra pune dhe familje, dhe mundoheshin t'i jepnin kurrë, me fjalë zemre, me fjalë prej shpirti, njëri-tjetrit për dhimbjen e madhe që i solli gjithë Partisë e popullit tonë vdekja e Udhëheqësit tonë të shquar, njeriut më të dashur të zemrave tona, shokut Enver Hoxha.

I gjithë ky grumbullim i madh njerëzish, të jepte përfytyrimin e një familjeje të madhe, të nderuar, fisnike, që ka pësuar një ngjarje të rëndë, një dhimbje të madhe. Po, e tillë është edhe Tirana. Një familje e madhe njerëzish, me mbi 210 mijë banorë, me një harmoni të madhe, me një unitet të shkëlqyer, që e krijoi Partia e Punës e Shqipërisë me në krye Udhëheqësin e saj të lavdishëm, shokun Enver.

Njerëzit heshtnin, heshtnin gjatë, mbushnin sytë, por gjenin edhe forcë të jashtëzakonshme t'i thoshnin shokut, shoqes, veteranit, nxënësit, një fjalë të urtë, një fjalë partie, një fjalë kurajoje, të cilat s'mund të jepen dot të gjitha në këto rrahë.

- Ne jemi të fortë se na ka udhëhequr e kalitur Partia dhe Enver Hoxha për dekada të tëra. Prandaj, t'i shtrengojmë edhe më shumë rradhët rreth Komitetit Qendror.

- Të forcojmë unitetin e popullit, që është vepër e bukur e Partisë dhe e shokut Enver.

- Të dashur nxënës, unë, mësuesja juaj kujdestare, s'mund të mendoja se do t'ju jepja këtë lajm të hidhur. S'ka shumë ditë kur ne mësuesim këtu, në klasë, vargjet e poezisë popullore: M'u si mal në rrëzë mali/ Erdhi Enver Hoxha vetë/ Syri i tij çika stërralli/ Fjala e tij gjëmon si det/ ...S'gjenden dot, të dashur nxënës, fjalët për të shprehur dashurinë e madhe që kemi për shokun Enver, si dhe dhimbjen që ndiejmë.

- E ndiejmë se dhimbja është e madhe, por ne do ta kthejmë në forcë, se kështu na ka mësuar Partia dhe vetë shoku Enver. Ne i betohemi Partisë se fjalët e shokut Enver, që e ardhmja do të jetë më e shkëlqyer, do ta bëjmë realitet.

- Na ka dashur shumë ne, të rinjtë shoku Enver. Gjithmonë na ka qëndruar pranë, na ka dhënë këshilla prej mësuesi, prej Udhëheqësi.

- 5 herë ka ardhur tek ne, në uzinën «Enver» shoku Enver. Ne s'mund t'i harrojmë kurrë ato vizita, ato këshilla, ato fjalë të ngrohta. Unë s'mund të harroj kurrë atë ditë të marsit të 1967-ës, kur shoku Enver mori pjesë në mbledhjen tonë të organizatës-bazë të Partisë. Ai u ul në një bankë me mua. Propozova që shoku Enver të ulej në presidium. Ai s'punoi dhe tha se kish ardhur si komunist i thjeshtë për të dëgjuar. Dhe në fund të mbledhjes tha: «Jam shumë i gëzuar që mora pjesë në mbledhjen e organizatës tuaj. Këtu unë mësova nga ju shumë gjëra, që do të më shërbejnë në punën tonë të Partisë...».

- Rron socializmi, rron Shqipëria, rron Partia, prandaj rron e do të rroj shoku Enver gjithmonë në zemrat tona.

Zërat e kujt janë këto biseda, që ne po i rreshtojmë këtu? Është zëri i punëtorëve të uzinës «Enver», është zëri i Heroit të Punës Socialiste Lec Barbullushi, është zëri i punëtorit remontier, komunistit që ka qenë pranë shokut Enver në marsin e '67-ës, Ibrahim Xhunga, është zëri i punëtorit të uzinës «Dinamo», i të rinjve të uzinës «Tirana», është zëri i mësueses kujdestare Afërdita Havari në shkollën «Partizani», është zëri i nxënësës Lindita Dobi, është zëri i nxënësve të shkollës së mesme pedagogjike, që hoqën jakat e bardha mbi përparësit e zëra dhe i dhanë kurajon e madhe njëra-tjetër, është zëri i studentit të Universitetit të Tiranës, është zëri i banorit pranë Shtëpisë së Partisë në Lagjen nr. 3, është zëri i pezakut trim e të besës me Partinë, është zëri i veteranit të nderuar Esat Dishnica, është zëri...

Janë zërat e të gjithëve që janë këtu në Tiranë, dhjetëra mijëra. Ky është zëri i të gjithë pjesëtarëve të kësaj familjeje të madhe, të cilët i pamë edhe dje, më tepër se kurrë, të bashkuar me një fjalë zemre, me një fjalë dhimbjeje të thellë, me një fjalë të urtë, të mënçur kurajoje. Dhe jo vetëm kaq, por të lidhur madhërisht me punën.

- Nuk më ka ndodhur kurrë kështu, - na thotë Hysen Bardhi, drejtori i uzinës «Enver». - Të gjithë punojnë në terno, pastrojnë terrenet, sheshin, xhamat dhe të shikojnë në sy, sikur të pyesin: «Shoku drejtor a ka ndonjë punë për ne?». E ç'ta zgjatim? Kështu ndodh në familjet e mira, të shëndosha, harmonike ku punon një mendje, ku rreh një zemër.

ASTRIT NURI

DIBER

PARTIA DO TE RROJE SA ÇI DONTË ZEMRA ENVERIT

Në orën 12, kur Radio-Tirana dha lajmin e hidhur për vdekjen e njeriut më të dashur e më të shtrenjtë të zemrave tona, Udhëheqësit të dashur të Partisë dhe të popullit, shokut Enver Hoxha, shoferit Baf-tjar Zeneli, që udhëtonte për në Zalldardhë të Dibrës, i shkrepën lotët dhe iu dridh pakëz timoni...

- Mos, bre, mos ta kishe thanë.

- Mbahu vëlla...

Por lotët nuk mbahen lehtë. Duket sikur edhe lulet e pranverës e kanë ndalur pakëz shpërthimin nga ky pikëllim i madh, duket sikur edhe Drini e zgjeroi shtratin e vet nga këto lotë.

- A ka qenë në këto anë shoku Enver? - pyet Saliko Hajno, një djallë Tepelene.

- E ku nuk ka qenë i miri, ku nuk ka qenë, - thotë Baf-tjari. Ja m'u këtu në Zdojan na ka folur në dibraneve. Mjaltë goja. E di ti. Këto pemëtore që të sheh syri që atëherë u bënë. Lulëzoi dheu pasi foli Ai.

Pastaj prapë heshtje. Dhe përsëri bisedë për këshilla të Enverit.

Male shumë ka Shqipëria, - thotë duke iu dridhur buza mixha Xhe-tan Shira në Zalldardhë. Ja tek asht edhe Korabi ynë, m'u përpara syve. Po Enveri që mal mbi male, mali ma i kaltë i Shqipërisë. Partia të rroj!

- Të lumtë goja, or mixhë, Partia e Enverit do të rrojë sa ç'i dontë zemra atij, - thotë Veli Troçi, sekretar i byrosë së Partisë për kooperativën.

- Ju rinia e keni udhën e çelë, hapni sytë si thoshte Enveri, e po batë si thoshte Ai, hiç gjale s'ka me pasë Shqipëria, për besë.

- Po besa besë, na një herë i jem betue e me fjalën e tij kemi me dëkë.

Cdo vatër dibrane, si e tërë Shqipëria është në zi. Xhetan Ismeria, komunist i vjetër në Muhur, pret njerëz, sikur të ketë mort në shtëpi të vet. Oda e miqve është e mbushur. Plaku hesht, ndërsa e përkëdhel me mall fotografinë e Udhëheqësit tonë të shtrenjtë.

Plaku bisedon me portretin. Pastaj me traktoristët që kanë shuar traktorët një grimë herë e kanë lënë hullitë përgjysmë të pijnë një kafe këtu tok të mbledhur si gish-tat e dorës në një grusht të vetëm.

- E kam takuar kur na erdhi atëherë, në tërmetin e dhjetorit, - tregon Xhetani.

- A e mban mend ç'të tha?

- Na pyeti ç'bajshim kur bijshin tërmete në të kaluarën. Ç'ka më i diffute se, me i thanë se kurrkush nuk na e qante hallin me fukarasë.

- Kurse Enveri erdhi vetë, e na e vuni dorën në ballë si djemve të vet, - ndërhyu Rexhep Cara. Na ndriti vatrën Enveri që do t'i ndritë emri sa të jetë jeta. Dhe ka për t'i ndritë se edhe foshnja kur mëson emrin e prindit, mëson emrin e Enverit.

SAMI MILLOSHI

THANAS DINO

VENDIM

mbi shpalljen e zisë kombëtare për të nderuar kujtimin e shokut Enver Hoxha

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Socialiste të Shqipërisë, Këshilli i Ministrave i Republikës Socialiste të Shqipërisë, për të nderuar kujtimin dhe Veprën e Udhëheqësit të dashur të Partisë dhe të popullit shokut Enver Hoxha, vendosi të shpalli ditët: 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 prill Ditë Zie kombëtare.

Të gjitha institucionet dhe organet shtetërore dhe shoqërore të ngrenë Flamurin kombëtar në gjysmë shtize.

Të ndërpriten të gjitha shfaqjet teatrale, kinematografike, koncertet dhe aktivitetet e tjera kulturore e sportive.

Në kohën e varrimit, të ndërpri-

tet puna për 5 minuta në të gjitha qendrat e punës e të prodhimit dhe të bien sirenat e fabrikave, trenave dhe anijeve. Në të njëjtën kohë të bëhen njëzet e një breshëri me top në kryeqytetin e Atdheut tonë Tiranë dhe nga pesë breshëri në qytetet: Gjirokastrë, Vlorë, Krujë, Korçë, Peshkopë, Shkodër, Kukës, Berat, Durrës e Elbasan.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SE PUNËS TE SHQIPERISE

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR TE REPUBLIKES POPULLORE SOCIALISTE TE SHQIPERISE

KESHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKES POPULLORE SOCIALISTE TE SHQIPERISE

Tiranë, më 11 prill 1985

NJOFTIM

i komisionit për organizimin e varrimit të shokut Enver Hoxha

Për t'i bërë homazhet e fundit nga masat punonjëse, arkivoli me trupin e Udhëheqësit të Partisë dhe të popullit shokut Enver Hoxha, do të vendoset në sallën e Presidiumit të Kuvendit Popullor.

Homazhet do të bëhen në datën 12 deri 14 prill 1985 prej orës 9 deri 13 dhe prej orës 16 deri në 19 dhe në datën 15 prill prej orës 8

deri në orën 10. Mitingu në përmortshëm do të zhvillohet në orën 11 të datës 15 prill 1985, në Sheshin «Skënderbeu». Varrimi do të bëhet në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit.

NGA KOMISIONI

Tiranë, më 11 prill 1985

Angazhimi zbatohet nga çdo i ri

- Në hidrocentralin «Enver Hoxha» të Komantit nuk ka asnjë anëtar të BRPSH-së që nuk realizon normën -

Kur e pyet Fatmir Lishin, sekretar i Komitetit të Rinisë të Hidrocentralit «Enver Hoxha» se sa është numri i të rinjve që nuk realizojnë normat e punës, të përgjigjet menjëherë:

- Këtë kolonë e kemi hequr nga «evidencat» tona. Pranë saj kemi shtuar kolonën me këtë kërkesë: të rinj që tejkalojnë normat...

Se ç'punë fshihet, pas këtij realizimi e kupton më mirë kur shikon gjithë këta djem të rinj që vrapojnë natë e ditë udhëve të veprës së dritës për të arritur sa më parë tek gryka e galerisë, të sonda e çimentimit, pranë makinerisë apo në gurorë. Të gjitha këto nuk janë fronte të lehta pune. Përkundrazi. Po si është arritur atëherë ky angazhim i rinisë dhe kjo lidhje e madhe shpirtërore e tyre me veprën energjike?

Përgjigjen e merr kudo nga veprimtarët e organizatave e forumet të Rinisë, nga drejtuesit e organizatave-bazë të Partisë, e gjen të shkruar nëpër protokollat e mbledhjeve me moton: avancimi i detyrave për të dorëzuar veprën para afatit, kërkon në radhë të parë tejkalim të planit.

Lufta për të vënë rininë në ballë të punës ndërtimtare ka qenë dhe mbetet një nga objektivat kryesorë të punës së Partisë në hidrocentral. Dhe mbi shpatullat e rinisë bie një peshë e madhe e ndërtimit të këtij gjigandi madhështor të dritës. Ndaj organet dhe organizatat bazë të Partisë kudo e kudoherë u kanë qëndruar pranë organizatave të rinisë, duke u zëbërthyer direktivat e programet e Partisë, dhe kërkesat që shtrohen në lëvizjen revolucionare «Ku është rinia të jetë e përparuar». Objektivat e organizatave të Rinisë i gjejmë kudo të qarta, konkrete, të zëbërthyer për çdo brigadë, ekipazh e gjer për të rinjtë e vegantë. Një zëbërthim i tillë, jashtë kornizave të shablonizmit, ka siguruar ndjekjen në vazhdimësi të objektivave të nismës, duke parë angazhimin konkret të çdo të riu në punën e përditshme.

Është një punë e tillë që bëhet kudo, një jetë e gjallë organizative ato debate e ballafaqime të frytshme, që e kanë ngritur rininë e Komantit në vendin e të nderuarve. Shko në kantierin e prodhimit. Që në bisedën e parë sekretari i organi-

zatës bazë të Partisë, Shefqet Duli do të përmendë shembullin e mirë që japin të rinjtë në punë. «Kishim, thotë ai, edhe në vitin e kaluar probleme me organizatën e Rinisë të bazës së hekurit. Shkuaam dhe u shtruaam këmbëkryq me të rinjtë, që përbëjnë pothuajse gjithë efektivin e brigadës. Ua shpjguam se ç'do të thotë mosrealizimi i detyrave në këtë front, se lë pa punë hekurkthyesit në tunele, në digë e në sallën e makinerisë».

Pra, këmbana bie këtu e tingulli i dëgjohet në objekte. Të rinjtë dhanë mendime konkrete për organizimin e punës dhe u zotuan se do t'a ndryshojnë gjendjen. Dhe kështu ndodhi. Pak kohë më parë, në një aktiv partië në shkallë veprë u soll si shembull pozitiv kjo organizatë rinie që ka sekretar të riun Behar Hila. Pa u larguar nga ky kantier po sjellim edhe një shembull tjetër. Të rinjtë e fabrikës së betonit kanë ndërmarrë nismën: «Norma e shokut, norma jonë». Edhe kur mungon një i ri me arsye në punë, detyrën e tij e bëjnë shokët. Si arrihet kjo?... Së pari, duke punuar me nerva të tendosura dhe, së dyti duke zotëruar disa profesione. Kjo nisimë tashmë ka dalë jashtë kantierit dhe po përkrahet nga shumë organizata të tjera si në ato të mjeteve të rënda në kantierin e transportit, të brigadave «Ismet Sali Bruçaj», «Drita e Drinit», «16 Tetori» etj.

Se sa shumë janë të lidhur të rinjtë me punën, mjafton të sjellim edhe dy tre shembuj të shkëputur nga heroizmi i tyre në mposhtjen e vështirësive të krijuara nga natyra në dimrin e këtij viti. I riu elektrikist Latif Bitri me disa shokë të tjerë të brigadës «Ismet Sali Bruçaj», ndonëse nuk e kishin detyrë të brigadës së tyre, vunë jetën në rrezik duke lidhur rrjetin elektrik dhe shpëtuan pompën e digës nga përmbytja. Askush përveç ndërgjegjes së tij nuk e urdhëronte të riun kandidat për anëtar partie, Gjelo-sh Shkambin, kur dora që ngjitej për leva të sondës, ta bënte që ajo të «këndonte» papushim në galeritë e ngrira nga akulli. Nuk i dërgoi njeri fjalë të kthehej 22 vjeçarit Sokol Vistari nga Lekbibaj i Tropojës, por ai udhëtoi në këmbë përmes borës e furtunës për të mos munguar në punë.

TOMË DEDA

PRODHIME MBI PLANIN

Nga 13 kolektiva në rrethin e Librazhdit, 10 prej tyre i plotësuan apo i tejkaluan detyrat e 3-mujorit. Në shkallë rrethi u dhanë mbi planin 3 161 000 lekë prodhime. Detyra e eksportit u tejkalua me 651 mijë lekë valutë. Arritje të mira janë shënuar edhe në sektorë të tjerë, si në ndërtim-montime, shërbimet komunale në popull etj.

Në të gjithë zërat u përmbushën detyrat nga kolektivi i ndërmarrjes së grumbullimit. Në brigadat e sektorit e kantierit të ndërtim-minierës u punua me aksion dhe, për rrjedhim, u kryen 1,3 për qind betonime galerish dhe 3 për qind pu-

nime minerare mbi planifikimin. Sharrëtarët e ndërmarrjes së përpunim-drurit, duke shfrytëzuar më racionalisht ngastrat e thella në pyll, morën më shumë nga parashikimi 739 metra kub trupa gjithsej dhe 131 metra shtylla miniere. Mbështetje për ndërmarrjet e ndryshme u bënë shoferët e parkut të Përrenjasit, të cilët shfrytëzuan më mirë rimorkiot dhe zgjeruan punën me dy ndërresa. Për rrjedhim, u transportuan mbi planin qindra tonë mallra të ndryshme si minerale, lëndë drusore, materiale ndërtimi etj.

(Sipas ATSH-së)



Në kombinatin e autotraktorëve «Enver Hoxha» në Tiranë

LETRA NGA POPULLI

FEMIJET E LUMTUR TE QYTETIT TIM

Është diçka e mrekullueshme që sot të ne askush nuk bën vetë një jetë të tij, nuk e mbyll veten në një qerthull të ngushtë interesash, por gëzon me gëzimin e të gjithë njerëzve që ka rreth e rrotull. E gëzimi ta zgjeron edhe zemrën, t'i nxjerr në gjyhe fjalët e bukura kur nis të flasësh edhe për gjëra që në dukje nuk kanë asnjë lidhje me ty, po kur i sheh të gëzimi që të japin, zbulon se në të vërtetë janë pjesë e jotja. Unë jam i ri e nuk jam bërë ende prind, po nis e flas për fëmijët e më duket sikur flas për një gjë timen të dashur, të bukur.

Puna që bëj si ekonomist më jep mundësi që të shoh edhe dokumentet të ndryshme të cilat, si të thash edhe e plotësojnë më mirë tablonë e bukur që na sheh syri përditë nëpër rrugët e lulishtet e qytetit. Çdo vit në Lezhë lindin shumë fëmijë. Dhe po të kërkojë të mësojë për vdekshmërinë foshnjore, do të shënosh disa zero njëra pas tjetrës për të vënë një shifër shumë, shumë të vogël në fund. Sepse shërbimi shëndetësor fëmijëve u fillon pa lindur ende. Mjekët gjinekologë dhe infermieret mami, në konsultoret e qytetit dhe në spital bëjnë një punë të kujdesshme për nënën dhe fëmijën. Nuk ka shpërblim më të madh për të sesa lindja dhe rritja e një fëmije të shëndetshme.

Fëmijët bëjnë takim që të vegjëll me shqetësim në çerdhet, kopshet e duke u rritur, vazhdojnë pastaj në shkollat të vjetërgjare, të mesme e më tutje. Gjithkund kujdes i vegantë për ta. Fëmijët e ndjejnë ndaj që kur janë ende të vegjëll e nuk dinë shumë gjëra për botën e dëgjton të thonë «Teta Xhija është e mirë, mësuese Hamideja shumë e mirë, edukatore Terezina...». Duke folur me çiltërsinë e moshës, ata shprehin kështu edhe mirënjohjen për dashurinë që tregojnë tetat e kopshit apo mësueset e shkollës.

Dy motra, Bleda e Anisa, dy emra të bukur për dy fëmijë shumë të bukur. Bleda pak më e madhe, i mëson motrës më të vogël vjersha për Partinë, për Xhaxhi Enverin. T'i pyesësh se çfarë do të bëhen kur të rriten, të thonë: «Unë do të bëhem artiste edhe traktoriste. Unë do të bëhem mjeke, por edhe mësuese dua». Kjo siguri e shqetë e tyre nuk është vetëm ëndërr fëmijore, por perspektivë të cilën fillojnë ta kuptojnë pak nga pak edhe vogëlushët nga ato që mësojnë në kopshet e në shkollë, nga ato që dëgjojnë t'u thonë prindërit e që i shohin me sy.

- Xhaxhi Fatmiri! - më thërret Denis 6 vjeçar. - Unë do të bëhem aviator. - e bën me dorë lart drejt qiellit të kaltër, ku duket se fluturon një avion. Sa bukur, ai pa filluar shkollën ka zgjedhur profesionin e tij. Këto ëndërra nuk u lindin fëmijëve ashtu kot, në të zbrazët por ua frymëzojnë vetë bukuria e larmia e jetës që i rrethon, siguria e jetës që ua ka përgatitur me luftë e me mund një popull i tërë, i udhëhequr nga Partia dhe shoku Enver. Ndaj edhe janë më të bukura sepe më e bukur do të jetë vetë e ardhmja. Kështu, fëmijët siç mësohen të thurin ëndërra të bukura, mësohen edhe të punojnë për t'i bërë jetë këto ëndërra. Ky mësim i vyer që marrin fëmijët që në vogëli është një gjë e mrekullueshme që ndikon edhe në vetë karakterin e tyre që është duke u formuar, sepe i përgatit për jetën.

Shikoj me endje prindërit që marrin fëmijët në krah, në karrocë ose përdore dhe shëtisin në bulevardin e qytetit, shkojnë në teatrin e kukullave, në kinema, në majdisë të tjera shlodhëse. Tani para se t'i japësh dorën shokut ose shoqes, merr fëmijën në krah e përqafon atë pastaj takohesh me prindërit e tij. Ata nuk e marrin për keq, përkundrazi, qeshin. Ky veprim që mund të duket i thjeshtë në pamjen e parë, ka një kuptim të madh, tregon dashurinë dhe respektin që ka edukuar shoqëria jonë për fëmijët. Dhe dihet se respekti të rrit dinjitetin. Në të vërtetë, duke i respektuar kështu fëmijët, shoqëria jonë respektin të ardhmen e vet, edhe më të bukur.

Me këtë dinjitet që vjen gjithnjë duke u rritur, fëmijët bëhen edhe qytetarë të guximshëm e nuk ngurojnë të bëjnë edhe vërejtje për gjërat që i shohin se nuk janë bërë ashtu siç duhet. Prandaj, pyetja që më bëri një vogëlush se kur do të ngrihet këndi i lojrave të qytetit, kishte brenda një thumb që nuk mund të kalojë me të qeshur e as me një përkëdhelje të kokës. Ai dond përgjigje dhe jo me fjalë.

U ula dhe i hodha në letër këto mendime e ndjenja për fëmijët e qytetit tim se e sotmja që jetojmë na ka mësuar të shohim shumë më larg se vetja, të shohim në jetën që na rrethon e të ndiejmë kështu të na zgjerohen edhe kufijtë e jetës sonë.

FATMIR LOHJA
ekonomist, Lezhë

PER ZGJERIMIN E HORIZONTIT SHKENCOR

Në qytetëzën e studentëve në Tiranë organizohen veprimtari të shumta për edukimin e të rinjve. Krahas bisedave për situatën ndërkombëtare, interesim kanë ngjallur dhe ato për edukimin estetik dhe me karakter shkencor. Kështu, këtë ditë, pedagogu Kol Tahiri zhvilloi bisedën «Thjeshtësia proletare - tipar kryesor i njerëzve tanë». Adem Tama u foli të rinjve për kulturën e të folurit. Edhe bisedat me karakter shkencor për elektronikën, informatikën, lashtësinë e popullit tonë në dritën e zbulimeve arkeologjike të kohëve të fundit, të shoqëruara me filma e diapozitiva janë ndjekur me vëmendje nga shumë studentë. Studentët të filologjisë në një takim me aktorët Viktor Zhusti e Agim Shuke diskutuan rreth problemeve që trajtohen në dramën «Mësuesi i letërsisë».

Vend të mirë zenë edhe mbasditet tematike kushtuar studentëve të dalluar të fakulteteve të inxhinierisë mekanike, në ndërtimit, të shkencave politike, ekonomisë, etj.

(Sipas ATSH-së)

PERGJITHESOJNE PERVOJEN E MIRE

Për arritjen e zotimeve që kanë marrë këtë vit organizatat e Gruas në ekonomitë kushtjësore të rrethit të Pogradecit po përgjithësojnë shembullin e shoqeve më të përparura në frontin e prodhimit. Për këtë qëllim po përdoren forma të ndryshme pune, si takime, ballafaqime, pasditë tematike etj. Në ndërmarrjen bujqësore të qytetit është bërë i njohur shembulli i mjelseve që kanë tejkaluar detyrat e prodhimit të qumështit për tremujorin e parë. Objektivi i grave dhe vajzave të kooperativës bujqësore të Buçimasit është që në misër të sigurojnë një rendiment prej 65 kv për ha. Për të arritur këtë organizatat e BG kanë organizuar ballafaqime, ku është zbërthyer përvoja e kooperativisteve më me përvojë dhe janë caktuar detyra për të ardhmen. Ato i hodhën anëtarët e tyre në aksion për grumbullimin e plehut të nevojshëm, me synim që për çdo hektar, që do të zihet me misër, të përdoren rreth 200 kv pleh organik. Në kooperativat bujqësore të Kriçkovës, Trebinjës, Blacës, Lezhnicës etj., është propaganduar shembulli i grave dhe vajzave që nuk largohen nga fronti i punës pa realizuar normën ditore.

(Sipas ATSH-së)

Edukohen me qëndrimin socialist ndaj punës

Në veprimtarinë e tyre organizatat e Frontit Demokratik në rrethin e Kolonjës synojnë edukimin e anëtarëve të tyre për forcimin e qëndrimit socialist ndaj punës e pronës së përbashkët. Në fshatrat Qina, Radovickë, Çlirim, Shtikë etj., ato kanë organizuar ballafaqime me temë «Të ndjekim shembullin e kooperativistëve që bëjnë mbi 300 di-

të punë të normuara në vit». Në diskutime janë përcaktuar edhe faktorët që kanë çuar në këtë arritje si forcimi i disiplinës, organizimi i vogël i punës etj. Në këto dhe fshatit Dërrma, organizatat e FD janë ndalur edhe të përvoja e brigadave të të imtave. Është theksuar se këto rezultate e kanë burimin të puna e mirë për sigurimin e bazës

ushqimore dhe mbarëshkrimin e bagëtive, mundësi që i kanë dhe anëtarët e brigadave të tjera. Në fshatin Psar, këto organizata i kanë hedhur anëtarët në aksione për të kryer në kohë e me cilësi shërbimet në grurë, për të realizuar zotimin që të merren 2 kv për ha më shumë se rendimenti i planifikuar.

(Sipas ATSH-së)

MATERIALE TE REJA NEPER STENDAT E MUZEVE

ARKIVAT E NJEREZVE TE THJESHTE

Si një detyrim moral për brezat që do të vijjnë e për brezin e ri të Shqipërisë, sot, etërit dhe nënat tonë ulen të shkruajnë kujtimet e tyre për kohërat që kanë jetuar. Në sa e sa letra që i vijnë Muzeut historik të rrethit të Dibrës nga veteranë të luftës e të punës, bashkëngjitur me kujtimet e tyre do të gjejmë edhe këtë shënim: «Këto janë kujtimet e mia modeste për muzeun». Çfarë e ka detyruar, psh, mësuesin 80 e ca vjeçar Abdulla Çanaga nga Shkodra t'i dërgojë kujtimet e tij muzeut të Dibrës? Askush, përveç urdhrit të ndërgjegjës. Në fletore të plotë me kujtime ka dërguar ai. Në gjysmën e fletorës ka kujtimet vetëkëto për një periudhë 10-vjeçare si mësues në Dibër, kurse në gjysmën tjetër ka një kapitull që bën fjalë për trimërinë e Elez Isufit kundër zaptuesve të huaj.

Pas 50 vjetëve Abdullai tregon se si hapi shkollën e Sillovës për së pari më 1923. Sa informacion interesant në ato radhë kujtimesh. Tregon, bie fjala, se si e kishin pyetur organet e arsimit në Shkodër nëse i pëlqente të shkonte mësues në Dibër, ndonjë rruga ishte minimale, dhe si Abdullai e kishte mirëpritur këtë, mjaft që të shkolloneshin bijtë e popullit kudo që të ishin në Shqipëri. Pastaj thotë, se për mangësi të lokalit të shkollës

mësuesit i ka zhvilluar në çardakun e xhamisë së Sillovës, ku ka pasur afro 60 nxënës. Edhe më tej mësuesi veteran me mall thotë se i pëlqen të kujtojë emrat e disa nxënësve. Dhe këto nuk janë pak, por 87 emra, kurse për të tjerët kërkon të falur se nuk i mban mend. Sa fisnike shpalosen ndjenjat e tij atdhetare e arsimdashëse.

Janë të shumtë ata që i drejtohen muzeut për t'i dhuruar kujtimet. Dikush kujton ditët e kohës së zezë të regjimeve antipopullore, dikush kujton ditët e stuhishme të Luftës Nacionalçlirimtare, dikush kujton ditët e para të ndërtimit socialist apo ditët e kolektivizimit të bujqësisë. Kështu të tërë së bashku, si të thash, formojnë arkivin e madh të njerëzve të thjeshtë. Ngjet ai proces i natyreshëm plot atdhedashuri, që vë në dukje shoku Enver në Përhëndetjen e Tij me rastin e 40-vjetorit të Çlirimit «Më mirë e më qartë se sa në shkretësi e kancelarive të huaja historia jote e madhërisme, o popull heroik, është shkruar me gjak e me djersë dhe është kënduar brez pas brezi nga ti vetë».

Nga ky vlerësim i lartë për arkivat e njerëzve të thjeshtë të popullit do të thoshim se burojnë edhe një varg detyrash jo vetëm për punonjësit e muzeut, por për një rreth më të gjerë aktivistësh: për mësue-

sit e historisë e për inteligjencien në përgjithësi, për letrarët e historianët e të tjerë. Fjala është se ç'mund të bëjnë këta që në mënyrë të organizuar të shfrytëzojnë këta arkiva. Dibra jep një përvojë të mirë në këtë fushë. Ka një ngjarje të shënuar historike, ta zëmë, siç që përvjetori i 60-vjetorit të rënies së Elez Isufit. Atëherë, me këtë rast, në mënyrë të organizuar studiues të pasionuar mbledhën në popull kujtime rreth tij. Haziz Ndreu, bie fjala, një nga më të zellshmit në këtë fushë, mbledhi kujtimet e të bijës së Elez Isufit. Po me kujtime të mbledhura në popull ai hartoi një kumtesë për patriotin Isuf Xhelli. Por organizimi i mbledhjes së kujtimeve nuk bëhet vetëm në raste përvjetorësh. Kjo është një rrugë. Rruga tjetër është mbledhja e kujtimeve në bazë të një tematike të caktuar. Me fjalë të tjera: kujtime për Luftën Nacionalçlirimtare, ose kujtime për zhvillimet e fshatit tonë, apo kujtime për këtë apo atë dëshmor. Një organizim i tillë i punës bën që edhe të lehtësohet shkrimi i kujtimeve nga etërit dhe nënat tona, por ndërkohë edhe i nxit e i frymëzon ata në këtë veprimtari sa fisnike aq edhe rinuese për vetë ata. Ja sa bukur e thotë këtë Ali Xhika në hyrje të një fletoreje me kujtime për ndryshimet në fshat.

Traditat letrare dhe letërsia e sotme

Ecurinë e letërsisë sonë e përfytyrojmë gjithnjë si një ngjitje që ka në themelet e saj atë frymë e patos, atë ngjyrim e konceptim ideomocional që vjen e ruhet nga periudhat paraardhëse të saj, por që ushqehet dhe pasurohet nga realiteti i ri socialist. Letërsia e sotme është sintezë dhe zhvillim njëkohësisht, është mbështetje e frymës së shëndetshme që la e kaluara dhe ecje e sigurtë drejt mundësive të reja krijuese ideomatike. Nëse ajo po afirmohet me vlera të çmueshme të brendisë e të mjeshtërisë, me origjinalitet historik, me frymë të shëndoshë patriotike e karakter të theksuar demokratik, me thellimin e realizmit dhe vërtetësinë historike, me patosin e fuqishëm të pohimit të idealeve më të larta të njerëzimit, kjo është një vazhdimësi logjike, në një shkallë cilësish të re.

Vetëm nën udhëheqjen e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha, mbi bazën e një realiteti të ri shoqëror dhe politik si dhe në kuptimin e drejtë të rolit të trashëgimisë së mëparshme letrare, këto tipare mund të thellohen, të forcohen, duke i dhënë letërsisë tonë sigurinë e pasurimit dhe zhvillimit të mëtejshëm. Prandaj, kur studiojmë letërsinë tonë të realizmit socialist, e shohim atë në një sfond të gjerë historik, duke mos harruar vlerat e çmueshme që u krijuan në periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare dhe të viteve të Pavarësisë, vlera që në një farë mënyre iu nënshtruan detyrave të letërsisë së re, të epokës së socializmit. Në raport me këtë traditë, letërsia e re nuk që thjesht një huazim, ose ndikim i letërsisë së kaluar, por një hop cilësor, që e kërkonte vetë zhvillimi dialektik i jetës. Pra s'kemi tablonë e huazimit të një zhanri letrar, të një figuracioni «të preferuar», të disa elementëve të sistemit të vargjezimit, etj., por kemi lëvizje të mendimit krijues të artistëve më të shquar, atë të përgjithshme ideomatike, që përshkon rrjedhën e historisë.

Kur flasim për rolin që luan tradita në zhvillimin e letërsisë, kemi

parasysh krahas trashëgimisë së periudhave më të largëta, edhe traditën e re, në të cilën janë sintetizuar arritjet e stadeve më të hershme të zhvillimit letrar. Ka elementë të traditës së vjetër që e luajtën rolin e tyre në një moment të caktuar, ka elementë që ruajnë vlerat e tyre të pakapërcyeshme, duke marrë pjesë në zhvillimin e përgjithshëm të kulturës sonë. Nga kjo traditë rrjedhin ato burime që ushqyen letërsinë tonë të re. E këto burime erdhën që nga Naimi e De Rada, Noli e Migjeni të një varg poetësh të shquar si Agolli, Kadare, Siliqi, Arapi etj., duke u pasuruar me elemente të reja të përmbajtjes dhe të mjeshtërisë artistike. Por pikërisht në procesin e sintetizimit të arritjeve më të mira të së kaluarës u formua tradita e re e letërsisë shqiptare, njohja e rolit të së cilës përbën një aspekt të rëndësishëm të artit tonë bashkëkohor. Studimi i lidhjes midis traditës së vjetër, traditës së re dhe letërsisë aktuale qëndron jo thjesht në konstatimin e ndikimit, por në zbulimin e rezultetit krijues, i cili është i madh sa në mënyrë më të përkryer të jetë realizuar transformimi krijues i asaj që trashëgohet, i elementëve të përvetësuar. Prandaj nuk është themelore të përcaktohet nëse letërsia e sotme ka përvetësuar pjesërisht apo tërësisht atë që ishte krijuar më parë, por duhet gjetur ajo e përgjithshme që zhvillohet në mënyrë krijuese të individualitetit të ndryshme. Në rast të kundërt, do të flisnim për një imitim banal, epigonizëm.

Te artistët të talentuar përvetësimi i së mëparshme bëhet në mënyrë origjinale; madje ndonjëherë shkrimtari i bën një interpretim të ri ideeo-artistik burimit, për të krijuar vlera të reja. Kështu, motive të krijimtarisë së hershme popullore (e cila hyn gjithashtu në traditë) u bënë mbështetje për krijime origjinale, ku spikaste një forcë e re përgjithëse, një vështrim më i thellë filozofik e politik-shoqëror.

Rolin që luan tradita në zhvilli-

min e letërsisë aktuale mund ta shohim si ndikim të një autori të shquar ose dhe të një rryme ideoletrare. Kështu njihet roli që luajti poezia e Naimit me patosin e fuqishëm romantik sidomos në poezinë e viteve të para të çlirimit, dihet gjithashtu ndikimi i gjithë drejtimit realist të viteve 30 në poezinë e të rinjve të viteve 60, ose ndikimi i prozës satirike të po atyre viteve në lulëzimin e llojeve të ndryshme satirike. E në to s'patëm as imitim, as huazim, por një rrjedhje të brendshme, që erdhi e u bë sa e fuqishme e vitale aq dhe origjinale në kushtet e një realiteti të ri socialist.

Më specifik është problemi i rolit që luan tradita e re në letërsinë e realizmit socialist. Shkrimtarët paraardhës të letërsisë sonë të realizmit socialist ndikojnë jo vetëm drejtpërdrejt, por dhe përmes lëvizjes së përgjithshme të mendimit letrar e estetik, përmes ndikimit në zhvillimin e gjithë shoqërisë, duke e ushqyer atë dhe gjithë brezat e rinj të shkrimtarëve, që formohen në gjirin e kësaj letërsie. Veprat më të mira të letërsisë sonë ngrejnë nivelin e përgjithshëm ideol e estetik, nxjerrin kritere më të larta të vlerësimit artistik që ndikon në zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë së re. Pikërisht në këtë veçori shprehet thelbi i rolit të ri specifik që luan tradita e re në vazhdimësinë e letërsisë aktuale. Ajo që e takon traditën më të hershme me traditën e re dhe letërsinë aktuale është, në fund të fundit, pjesëmarrja aktive e ndërgjegjshme e shkrimtarëve në pasqyrimin dhe zgjidhjen e problemeve të rëndësishme të jetës. Sigurisht që në letërsinë tonë të realizmit socialist ky kuptim jo vetëm është më i ndërgjegjshëm, por mbi bazën e një botëkuptimi të ri, bëhet pikënisje për realizime me një përmbajtje më të thellë, që i përgjigjet fazës më të lartë të zhvillimit të deritanishëm të shoqërisë sonë.

FLORESHA DADO

NE SHERBIM TE RITJES SE EFEKTIVITETIT TE MESIMIT

Forcimi i bazës materialo-mësimore në shkollat e rrethit të Shkodrës, takimet me veteranë të luftës e të punës, vizitat në qendra pune e prodhimi, kooperativa bujqësore etj., kanë shërbyer për konkretizimin e lidhjen më ngushtë të mësimit me jetën e praktikën dhe përgatitjen ideoshkencore të nxënësve. Arritje më të mira kanë siguruar sidomos kolektivt e shkollave «Branko Kadaja», «Jordan Misja», industriale, «1 Maji», «11 Janari», veterinare, etj. Në të është synuar që për çdo orë mësimi të ketë mjet konkretizues, dhe për tema e kapituj të vegantë të sillen të dhëna nga prodhimi, nga përvoja e përparuar, duke përdorur një informacion të pasur shkencor.

Në shkollat e mesme të Koplikut, Bushatit, Tamarës, Mesit e Bajzës, ku janë ngritur kabinete të pasur edhe për lëndë profesionale si për bimët e arave, për mekanikën bujqësore, etj., bëhet punë e mirë për

lidhjen e mësimit me praktikën e prodhimit të gjërë për njohjen e përvojës së përparuar. Kabinete të pasur për shumë lëndë mësimi si atë të fizikës, gjeografisë, etj., janë ngritur kohët e fundit edhe në shkollën 8-vjeçare të fshatit Rranxa Bushat, që i shërbejnë përvetësimi të qëndrueshëm të dijeve. Ndërkaq, në disa nga shkollat e këtij rrethi janë organizuar edhe sesione shkencore për njohjen më mirë të nxënësve me probleme të historisë, gjuhës shqipe, të zhvillimit e të perspektivës së sektorëve të ndryshëm të ekonomisë së rrethit, etj.

Rezultatet e mira që po arrihen në përvetësimin e programit mësimor në shumë shkollat të rrethit të Matit janë rrjedhim edhe i kujdesit për konkretizimin e orës së mësimit, përdorimin e metodave aktive etj. Punë e mirë është bërë për pasurimin e bazës materialo-mësimore dhe për vënien e saj në shërbim të konkretizimit të orës së

mësimit. Duke punuar me aksion u përgatitën 9800 mjete mësimore, u ngritën 60 kabinete të rinj dhe u përmirësuan 85 të tjerë. Përvojë më të mirë kanë grumbulluar sidomos shkollat 8-vjeçare e të mesme në Klos, Zenisht, Fullqet, Darsi etj. Tani vëmendja është përqendruar në përdorimin me efektivitet të këtyre mjeteve. Vetëm në shkollën 8-vjeçare «31 Korriku» të qytetit të Burrelit është arritur që mbi 85 për qind e orëve të mësimit në lëndët e matematikës, biologjisë, fizikës të konkretizohen.

Për dobënie e kësaj pune flet fakti se mbi se 85 për qind e nxënësve të klasave të para dhe 55 për qind e atyre të klasave të dyta në këtë rreth i kanë përvetësuar elementët e mësimit në masën shumë mirë. Ndërkohë, në shumë klasa të shkollave 8-vjeçare është arritur një kalueshmëri e plotë.

(ATSH)

Shënime nga mbledhjet e rinisë të Brigadës

- Koha që kam mundur të ruaj e të kujtoj për jetën time është një kohë e shkurtër, rreth 55 vjeç, por ndryshimet e shumta e të pakrahësueshme më kanë bërë të mendoj e të kujtoj sikur jam shumë i motshëm. Pse ndodh kështu me Alin? Sepse ai kujton se dikur krahina e Çidhnsë me 14 katunde nuk kishte asnjë shkollë fillore, ndërsa në shkollën e Kastriotit mësonin bijtë e bajraktarëve, siç thotë ai. - Në këtë shkollë, në radhë të parë, mësonin djemtë e parisë, pastaj të miqve të tyre dhe pastaj kush të mbetesh. - Po sot? Në katundet e Çidhnsë ka 5 shkollë 8-vjeçare dhe një shkollë të mesme.

Vjela në mënyrë të organizuar e arkivave të njerëzve të thjeshtë ka, pra, disa të mira. Ajo i shërben pasurimit të muzeut, po edhe pasurimit shpirtëror të vetë veteranëve. Kështu që me gjithë përvojën e mirë mund të bëhet edhe më shumë. Së pari, muzeu ka mundësi të shtojë korrespondencën me shumë veteranë të luftës e të punës për vjelljen e kujtimeve. Së dyti, a majfakt që kujtimet e veteranëve të mbeten vetëm në dosjet e muzeut? Jo. Dëgjim është bërë që ato të popularizohen nëpërmjet kumtesave në sesione shkencore, e të tjera forma. Por mund të bëhet më shumë. Gazeta lokale e rrethit, psh, mund të botojë më shpesh kujtime të shkurtëra të veteranëve. Pra, po të kërkojmë, format e punës gjenden, që këto vlera të bëhen pronë shpirtërore e brezit të ri.

Korresp. i «Zërit të popullit»

Vitin e kaluar, kur u festua 40-vjetori i formimit të Brigadës së 25-të Sulmuese, ish-kuadri i saj Jovan Antoni i dhuroi muzeut të brigadës një bllok me shënime të mbajtur në disa mbledhje të Komitetit të Rinisë së brigadës në muajt e parë të vitit 1945, kur kjo njësi luftarakë e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm e personalisht të shokut Enver Hoxha, i vazhdonte luftimet në Jugosllavi. Nëpërmjet këtyre shënimeve të thjeshta njihesh me aktivitetin e dendur e të shumanshëm që kishte rinia partizane e brigadës, që nga lufta për zhdukjen e analfabetizmit e deri te mbledhjet edukative e bisedat politike që zhvillonin në kohën midis betejave. Autori i shënimeve përmend se në mbledhjen e 10 shkurtit u vendos që të punoheshin temat «Revolucioni proletar», «Akuzat e borgjezisë komunistëve», «Mbi regjimin e Zogut», «Fashizmi dhe kolona e pestë». Po në këtë mbledhje, siç mësojmë nga shënime, është diskutuar për rëndësinë e garave, për përmirësimin e mëtejshëm të punës me gazetën e xhepit e të teatrit, si forma për të ndikuar «në rritje të entuziazmit të të rinjve». Për këtë qëllim «Brenda 20 ditort duhet të japim edhe dy kangë revolucionare».

Siç shihet, jeta e rinisë partizane, edhe pse në kushtet e vështira të

malit, zhvillohej në gjithanshmëri-në e vet. Në një mbledhje tjetër, të zhvilluar më 21 shkurt, mësojmë se «Në batalionin e parë asht formuar një kor i batalionit. Këtu baje pjesë 28 të rinj dhe mbrenda këtyre ditëve kanë masue kto kangë: 1) Mallet me blerim mbulue, 2) N'ato maja rripa - rripa, 3) Prej uris e prej mjerimit. Po ashtu, këngë të reja janë mësue edhe në batalionin e dytë e në tri kompanitë e batalionit të tretë». Në këtë mbledhje «gjithashtu u caktue se në rini duhet të zhvillohen mësimet dhe orë të lira ku të flitet mbi gjeografi, histori, astronomi dhe fizikë».

Por, pika më e rëndësishme e veprimtarisë së rinisë së brigadës, siç del edhe nga diskutimet, mbetet shtimi i organizatës së Partisë me gjak të ri komunist prej radhëve të saj. Autori i shënimeve përmend emra shokësh, të pranuar në radhët e Partisë, na njeh me detyrat që i caktonte organizata e Partisë vazhdimisht organizatës së rinisë në këtë drejtim, tregon si u realizuan ato. Gjithashtu në këtë bllok gjejmë edhe shënime e mbajtura në Konferencën e parë të aktivitetit të rinisë së brigadës të mbajtur më 24 shkurt 1945, e cila i dha një impuls të ri tërë veprimtarisë së saj.

MUSTAFA BESTARI

ANGLI

DEMONSTRATE ANTIBERTHAMORE

LONDER, 11 prill. - Bëhet e ditur se dje u zhvillua një demonstratë tjetër proteste kundër pranisë ushtarake amerikane në Britani. Protestues të shumtë hodhën parulla antimilitariste dhe bllokuan rrugët përreth bazës ushtarake ajrore amerikane Elkonberi, 90 kilometra në veri të Londrës. Agjencitë e lajmeve vënë në dukje se në këtë bazë janë vendosur aeroplanë spiunë

amerikanë të lartësive të mëdha «Tr-1». Kundër demonstruesve ndërhyri policia ushtarake, e cila bëri dhjetëra arrestime. Sikurse dihet, në Britani ka disa kohë që ka shpërthyer një lëvizje e gjërë kundër dislokimit të armëve bërthamore amerikane në këtë vend, e në përgjithësi kundër pranisë ushtarake amerikane në territorin britanik. (ATSH)

TOKAT E PUSHTUARA ARABE

Intensifikohet terrori gjyqësor kundër banorëve palestinezë

JERUSALEM, 11 prill. - Regjimi sionist i Tel-Avivit po e intensifikon gjithmonë e më shumë terrorin gjyqësor kundër banorëve palestinezë. Sikurse bëjnë të ditur agjencitë e lajmeve, tetë palestinezë të tjerë u dënuan këto ditë me afatë të rënda burgimi për pjesëmarrje në demonstratë e protestës kundër politikës dhe veprimtarisë aneksoniste e shkombëtarizuese që ndjekin agresorët izraelitë në territoret e pushtuara. Tani pothuajse është dyfishuar afati i burgimit për palestinezët që marrin pjesë në manifestimet antiizraelite dhe në përlëshjet me forcat ushtarake-policore të pushtuesve.

Agjencitë e lajmeve, të cilat u referohen statistikave të botuara në shtypin izraelit, theksojnë se numri i banorëve palestinezë që kanë dalë vitin e kaluar para gjyqeve ushtarake izraelite në Cisjordan dhe në Rripin e Gazës llogaritet në afro 6 700, në krahasim me 3 500 që ishte kjo shifër në vitin paraardhës. Për pasojë, pothuajse është dyfishuar edhe numri i dënimeve të dhëna nga gjykatat ushtarake sioniste në këto territore. Dhjetëra mijë palestinezët që mbahen të mbyllur në qelqitë e burgjeve izraelite u nënshtrohen torturave barbare.

(Sipas ATSH-së)

LIBANI I JUGUT

VEPRIME BRUTALE TË PUSHTUESVE IZRAELITË KUNDËR PALESTINEZEVË

BEJRUT, 11 prill. - Krahas rritjes së dhunës kundër popullsisë civile libaneze në Libanin e Jugut, trupat izraelite po kryejnë akte të përditshme terroriste kundër refugjatëve palestinezë në këtë vend. Njoftimet e agjencive të lajmeve bëjnë të ditur se forca të shumta izraelite, të mbështetura nga dhjetëra tanke e autobinda, rrethuan sot kampin e refugjatëve palestinezë të Rashadjeut, rreth 8 km në jug të qytetit Tir. Ata filluan një operacion të gjërë kontrolli e bastisjes shtëpi me shtëpi dhe urdhëruan të gjithë burrat të grumbullohen në qendër të kampit. Njoftimet theksojnë se më tepër se 1200 palestinezë

neze u nënshtrohen për orë të tëra veprimeve brutale dhe torturave, nën pretekstin e zbulimit të «personave të dyshimtë». Shumë shtëpi u shkatërruan dhe qindra veta u arrestuan nga pushtuesit.

Ndërkohë, bëhet e ditur se forcat libaneze të rezistencës qëlluan sot me mortaja një pozicion ushtarak izraelit në afërsi të lokalitetit Xhib-Xhenin, në rajonin e Bekas perendimore. Komunikata e botuar me këtë rast nga atdhetarët libanezë vintë në dukje se disa objekte ushtarake izraelite u goditën dhe motën zjarr, ndërsa në radhët e ushtarëve armiq pati mjaft të vrarë e të plagosur. (ATSH)

SHBA

Uashingtoni synon të përdorë arritjet shkencore të vendeve të tjera për rritjen e potencialit të vet ushtarak

- Sipas një raporti të Shtëpisë së Bardhë -

UASHINGTON, 11 prill. - Sikurse bëjnë të ditur agjencitë e lajmeve, presidenti amerikan Regan i dërgoi Kongresit amerikan një raport lidhur me «bashkëpunimin» e Shteteve të Bashkuara me vendet e tjera perëndimore në fushën e shkencës e të teknologjisë. Në raport theksohet se Shtetet e Bashkuara do të shtojnë përpjekjet në të ardhmen për të shfrytëzuar më gjërësisht arritjet shkencore e teknologjike të vendeve aleate për fuqizimin e makinës amerikane të luftës. SHBA, thuhet në këtë dokument të Shtëpisë së Bardhë, po i kushtojnë një vëmendje gjithnjë e më të madhe përdorimit të potencialit shkencor e teknik të vendeve të tjera për forcimin ushtarak të tyre. Lidhur me këtë, përmendet seksioni i posaçëm për çështjet shkencore, që është

krijuar në bllokun e NATO-s dhe që ka si qëllim kryesor të furnizojë Pentagonin me arritjet teknologjike që mund të gjejnë zbatim në programet ushtarake. Në veçanti, raporti thekson synimet e Uashingtonit për të angazhuar vendet aleate në realizimin e programit të kërkimeve për armët moderne me bazë në kozmos.

Zyrtarë të administratës së Reganit bëjnë të ditur kohët e fundit se po zhvillohen kontakte intensive me firma të huaja për të përfunduar kontrata për programin e «luftës së yjeve». Ata theksojnë se për këtë qëllim do të përdoret një pjesë e mirë e fondit prej 26 miliardë dollarësh të caktuar për realizimin e këtij programi.

(ATSH)

SALVADOR

Aksione të atdhetarëve në Çalatenango

SAN-SALVADOR, 11 prill. - Agjencitë e lajmeve njoftojnë se gjatë ditëve të fundit atdhetarët salvadorianë kryen dy aksione të armatosura kundër trupave ushtarake të regjimit të Duarte në perëndim të departamentit të Çalatenangos dhe në fshatin e Santa Kruz Lomas në departamentin e La Pazit. Si rezultat i këtyre aksioneve, u vrarë 25 ushtarakë të regjimit dhe bashkëpunëtorë të tij. Po kështu atdhetarët kapën një numër të madh armësh dhe pajisjesh ushtarake. (ATSH)

AMERIKA LATINE

NJË NGA KRIZAT ME TË RENDË

TIRANË, 11 prill. - Sipas një raporti të një organizmi që merret me probleme ekonomike të OKB-së, «vendet e Amerikës Latine po kalojnë krizën më të rëndë që nga vitet '30», ndërkohë që në të, midis të tjerash, theksohet se «përspektivat për daljen prej saj po bëhen gjithnjë e më të errëta, për shkak të thellimit të vazhdueshëm të krizës».

Gjatë 12 muajve të fundit, inflacioni mesatar në Amerikën Latine arriti në 116 për qind, shifër kjo rekord në këtë kontinent që prej vitit 1932. Kjo shifër është 15 për qind më e lartë se në vitin 1983 dhe dy herë më e lartë se në vitin 1981. Në disa vende të veçanta shifra e inflacionit ka arritur përmasa të papara ndonjëherë në histori. Në Bolivë p.sh. inflacioni arriti gjatë vitit të kaluar 270 për qind, në Brazil mbi 220 për qind, etj. Papunësia gjithashtu është një plagë e rëndë sociale, që ka prekur miliona e miliona veta në këto vende. Sipas të dhënave të ndryshme, në Amerikën Latine ka rreth 60 milionë të papunë ose gjysëm të papunë. Në krye të vendeve që kanë papunësinë më të madhe është Kili, ku në ushtrinë e «krahëve të tepër» bëjnë pjesë 22 për qind e forcës së aftë për punë. Pas tij vijnë Venezuela - 20 për qind, Urugvaj - 16 për qind, Paraguaj - 15 për qind, etj. (ATSH)

Rënie e vlerës së dollarit

UASHINGTON, 11 prill. - Agjencitë e lajmeve, bëjnë të ditur se dollari amerikan pësoi një rënie të konsiderueshme të vlerës së tij kundrejt monedhave evropianoperëndimore në tregjet valutore ndërkombëtare. Vlera e dollarit u ul kundrejt sterlinës angleze, e cila tani shkëmbehet me 1,25 dollarë, 3 cent më shumë se pak kohë më parë. Kjo konsiderohet si rënia më e madhe e vlerës së dollarit amerikan brenda pesë muajve në raport me sterlinën angleze. Rënie të ndjeshme shënoi dollari edhe në bursa të tjera evropianoperëndimore. Agjencitë e ndryshme të lajmeve shtojnë me këtë rast, se rënia e tanishme e dollarit amerikan shpreh ashpërsimin e krizës financiare ndërkombëtare.

Ekspertë të ndryshëm ekonomistë vënë në dukje se kjo nuk është rënia e parë e vlerës së dollarit gjatë këtyre kohëve të fundit. Rënitë e vlerës së dollarit janë një tregues tjetër i krizës së ekonomisë amerikane.

KILI

Organizohet dita e protestës kombëtare

- Ushtria dhe policia ushtrojnë raprezalje e arrestime -

SANTIAGO, 11 prill. - Agjencitë e lajmeve njoftojnë se sot në Kili u organizua dita e protestës kombëtare kundër regjimit fashist të Pinoçetit. Në kryeqytet dhe në qytete të tjera të vendit u organizuan mitingje, manifestime e demonstrata të shumta, ku pjesëmarrësit dënonin dhunën e egër policore dhe shtypjen

e madhe të masave punonjëse. Në disa qytete, atdhetarët sulmuan edhe objekte të ndryshme të policisë. Kjo ditë e re e protestës kombëtare shkaktoi një panik të madh në tërësi të vendit. Ushtria dhe policia u vunë në alarm dhe ndërmorën një varg raprezallesh e arrestimesh kundër demonstruesve.

AFRIKA E JUGUT

DHUNE E EGER RACISTE

- Më se 300 të vrarë që prej muajit gusht -

PRETORIA, 11 prill. - Agjencitë e lajmeve njoftojnë se në shumë geto zeake në Afrikën e Jugut vazhdojnë protestat kundër politikës së aparteidit që ndjek regjimi i Pretorias. Protesta ka pasur sidomos në pjesën lindore të provincës së Kejpit, në Kimberlei, Kahtlehong në lindje të Johannesburgut dhe në provincën e Oranzhit. Protestuesit zeakë dënuan shtypjen dhe terrorin racist që ushtrohet ndaj tyre. Gjithashtu ata goditën me gurë dhe hodhën shishe me benzinë kundër makinave të policisë dhe ushtrisë.

Bëhet e ditur se protestave zeake regjimi i Bothas po i përgjigjet me dhunë e terror. Njoftimet zyrtare nga Pretoria vënë në dukje se «forcat e rendit» përdorën bomba me gaz lotsjellës, pompat e ujit si dhe armët e zjarrit për të shpërndarë demonstruesit. Shumë prej zeakëve pjesëmarrës në demonstrata u arrestuan. Në një deklaratë që bëri pardje para parlamentit racist, mi-

nistri jugafrikan i Punëve të Brendshme, Luis lë Granzh, pohoi se që prej një viti në Afrikën e Jugut janë arrestuar 11 688 zeakë. Arsyeja e arrestimit të tyre, sipas tij, ishte shkelja e ligjit të shtetrrëthimit, të vendosur në qytetet kryesore të Afrikës së Jugut si Pretoria, Kejptauni, Johannesburgu etj. Agjencitë e lajmeve bëjnë të ditur se, sipas këtij ligji, zeakët nuk kanë të drejtë të hyjnë në zonat e rezervuara vetëm për të bardhët. Përveç kësaj banorët me ngjyrë janë të detyruar të braktisin banesat e tyre dhe të vendosen nëpër getot zeake apo nëpër bandustanet e ngritura në thellësi të vendit. Në të njëjtën kohë njoftohet se që prej gushtit të vitit të kaluar regjimi i Bothas ka vrarë më shumë se 300 zeakë që kanë marrë pjesë në lëvizjen e protestës antiraciste në Afrikën e Jugut. (ATSH)

Nën peshën e rëndë të borxheve të jashtme

TIRANË, 11 prill. - Sipas të dhënave statistikore të një raporti të Bankës Botërore, detyrimet e vendeve të pazhvilluara ndaj kapitalit të huaj financiar në fund të vitit 1985 do të arrijnë shumën prej 970 miliardë dollarësh, në krahasim me 900 miliardë në vitin 1984. Gjatë vitit të kaluar, vitet në dukje në raportin e mësipërm, këto vende u detyruan të shpenzonin 92 miliardë dollarë për të shlyer kështu vjetore dhe përqindjet e interesit ndaj institucioneve të huaja financiare kreditore. Vështirësitë financiare për vendet e pazhvilluara gjatë periudhës në fjalë u bënë edhe më të theksuara për shkak të përqindjeve gjithnjë e më të larta të interesit bankar, të çmimeve të ulëta për mallrat e eksportit dhe të çmimeve të larta për artikujt e importit. Në bazë të të dhënave të OKB-së, për shkak të tregtisë së pabarabartë dhe të marrëdhënieve ekonomike me kushte diskriminuuese, vendet kapitaliste të industrializuara vetëm vendeve të Kontinentit Afrikan u shkaktojnë çdo vit një humbje prej 6

miliardë dollarësh. Gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit, borxhet e jashtme të vendeve të pazhvilluara janë, katërfishuar. Vitin që shkoj, vetëm për shlyerjen e përqindjeve të interesit këto vende shpenzuan më se një të tretën e të ardhurave të tyre nga eksporti. Për çdo dollar të investuar në vendet e pazhvilluara, shoqëritë shumëkombëshe marrin një fitim që arrin deri në shtatë dollarë, duke i shndërruar këto vende në shtojca të metropoleve imperialiste si burim lëndësh të para e fuqie punëtore me çmim fare të lirë dhe si sferë mjaft fitimprurëse për investimet e monopoleve kapitaliste. Fitimet vjetore të shoqërive shumëkombëshe nga grabitja e egër neokolonialiste e vendeve të pazhvilluara në këta katër vjetet e fundit janë dyfishuar në krahasim me vitet 70-të dhe kanë arritur në rreth 200 miliardë dollarë. Ndërkaq, numri i njerëzve të varfër në këto vende llogaritet në afro 2 miliardë e 500 mijë syresh, që vuajnë për bukën e gojës. (ATSH)

RRITJE E SHPEJTE E SHPENZIMEVE PER ARMATIMET, NE VENDET KAPITALISTE

UASHINGTON, 11 prill. Fryrja e vazhdueshme e buxheteve për mbajtjen e makinës burokratike të shtetit borgjez, rritja e shpejtë e shpenzimeve inprodutive dhe, në veçanti, e shpenzimeve për armatimet është bërë një fenomen tipik për vendet e botës kapitaliste. Për këtë flasin qartë të dhënat e një raporti, të botuar së fundi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Në raport vihet në dukje se buxhe-

tet qeveritare të vendeve kapitaliste zinin në vitin 1981 më se 41 për qind të vlerës së prodhimit të përgjithshëm kombëtar të këtyre vendeve, në krahasim me 35,9 për qind që zinin në vitin 1974. Vitet e fundit ato janë rritur me ritme edhe më të shpejta. Në disa vende të industrializuara kapitaliste gllabërojnë gjysmën e të ardhurave kombëtare vjetore.

Në raportin e sipërpërmendur po-

hohet se faktori kryesor në fryrjen me shpejtësi të buxheteve qeveritare është rritja e theksuar e shpenzimeve për qëllime ushtarake. Vendet e industrializuara kapitaliste përdorin për qëllime ushtarake afro-15 për qind të buxheteve qeveritare, por në fakt kjo shifër është më e madhe sepse fonde të tjera buxhetore shkojnë për armatimet nën etiketë të ndryshme. (Sipas ATSH-së)

EKUADOR

Thirrje për depërtim të kapitalit të huaj

UASHINGTON, 11 prill. - Në një fjalim që mbajti në Nju Xhersi, në kuadrin e një vizite zyrtare disidatore që po bën në SHBA, presidenti i Ekuadorit, Febres-Kordero, bëri thirrje për rritjen e investimeve të kapitalit të huaj monopolist në vendin e tij dhe në vendet e tjera nënkontinentit latinoamerikan. Duke bërë fjalë për pasuritë e mëdha natyrore të vendit të tij, presidenti ekuadorian u kërkoi afaristëve amerikanë që të investojnë në shumë kapitale. Në një konferencë shtypi të organizuar pas këtij fjalimi, ai deklaroi se «ne e mirëpresim kapitalin e huaj» dhe shtoi se qeveria e kryesuar prej tij do të inkurajojë sidomos investimet në sektorin e industrisë nxjerrëse. Sikurse vënë në dukje njoftimet, të njëjtën gjë kërkoi ai edhe në bisedimet që zhvilloi me nënpresidentin e SHBA-së, Bush, dhe me zyrtarë të tjerë të administratës amerikane. (ATSH)

ME PAK FJALE

GJENEVE. - Njoftohet se në Gjenezë u mbajt pardje një mbledhje e komisionit sovieto-amerikan për mbikqyrjen e zbatimit të marrëveshjes «SALT-1» të përfunduar nga Uashingtoni dhe Moskë në vitin 1972. Njoftimet theksojnë se mbledhja u hap në atmosferën e akuzave të ndërsjella për shkeljen e kësaj marrëveshjeje.

AMAN. - Agjencitë e lajmeve bëjnë të ditur se mbreti Husein i Jordanisë dhe kryetari i OCP-së, Arafat, u takuan pardje në Aman dhe zhvilluan bisedime lidhur me marrëveshjen jordano-palestineze të përfunduar në muajin shkurt.

RABAT. - Bëhet e ditur se sekretari amerikan i forcave tokësore, Xhon Marsh, mbërriti pardje për vizitë në Marok. (ATSH)

KOLEGIUMI I REDAKSISE

Moti dje dhe parashikimi për sot

Mbi vendin tonë ka qenë mot me vranësira të shtrëguata dhe kthjellime. Era ka fryrë e lehtë dhe pjesërisht mesatare nga ana e perëndimit. Temperaturat më të ulëta dhe më të larta kanë qenë: Shkoder 15 dhe 20, Kukësi 16 dhe 25, Peshkopia 13 dhe 24, Tirana 15 dhe 25, Du-

rresë 16 dhe 19, Elbasani 14 dhe 23, Lushnja 15 dhe 23, Qyteti Stalin 13 dhe 26, Fieri 14 dhe 20, Korça 10 dhe 22, Vlora 14 dhe 28, Gjirokastra 12 dhe 24, Saranda 11 dhe 20 gradë Celsius. Gjatë ditës së sotme do të jetë mot me vranësira të shtrëguata dhe kthjellime.

me, Era do të fryjë e lehtë dhe mesatare nga ana e veriperëndimit. Temperatura më e ulët dhe më e lartë në vendet malore do të jetë 8 dhe 19, në vendet e ulëta 8 dhe 24, në bregdet 12 dhe 19 gradë Celsius.

Shërbimi sinoptik

RADIO

E premte, 12 prill 1985

5.00 Hapja e programit, lajmet dhe kalendari enciklopedik, (Me valë të mesme 221, 238, 275, 330, 347 e 463 metra dhe me të shkurtra 60 metra); 5.10 Muzikë simfonike; 6.00 Lajmet, pasqyra informative e shtypit të ditës, kalendari enciklopedik dhe parashikimi i motit; 6.10 Muzikë simfonike; 7.00 Emission për fëmijë; 7.15 Muzikë simfonike; 8.00 Lajmet, pasqyra e shtypit të ditës dhe programi i Radios; 8.15 Muzikë simfonike; 10.00 Lajmet dhe material nga gazetat; 10.10 Muzikë simfonike; 12.00 Lajmet; 12.10 Muzikë simfonike; 13.30 Nga shtypi i ditës;

13.35 Muzikë simfonike; 14.00 Lajmet; 14.10 Muzikë simfonike; 15.30 Emissioni i lajmeve; 15.45 Muzikë simfonike; 16.00 «Shoku Enver Hoxha për luftën e popujve e të klasës punëtore ndërkombëtare»; 16.10 Muzikë simfonike; 17.30 «Shoku Enver Hoxha për zhvillimin e ekonomisë sonë socialiste»; 17.45 Muzikë simfonike; 18.00 Lajmet dhe programi i Radios për datën 13 prill 1985; 18.10 Muzikë simfonike; 18.35 Rubrika: «Të prodhohet me efektivitet të lartë». Në minierën e Memaliajt, Tepelenë; 18.50 Muzikë simfonike; 19.00 «Shoku Enver Hoxha për zhvillimin e letërsisë e artit tonë»; 19.20 Muzikë simfonike; 20.00 Revista radiofonike e mbrëmjes; 20.30 Muzikë simfonike; 22.00 Lajmet kryesore të

ditës; 22.10 Muzikë simfonike; 22.55-23.00 Njohja me programin e Radios për ditën e nesërme dhe mbyllja e programit.

TELEVIZION

17.30 Programi; 17.32 Universiteti në Televizion: Arkeologji: Ilirët në epokën e hekurit - M. Korkuti. - Bashkëpunëtor i vjetër shkencor; 18.00 Emissioni i lajmeve; 18.15 Me duart tona: Pemëtarët e vegjël (Dibër); 18.40 Vepra simfonike; 19.00 Cikl: Punëtorët diskutojnë për shifrat e projektit të ri (Emissioni i tretë); 19.25 Vepra simfonike; 20.00 Revista televizive dhe koha; 20.30 Film artistik; 21.40 Emissioni i lajmeve; 21.55 Mbyllja e programit.

ADRESA E REDAKSISË, «ZËRI I POPULLIT», BULEVARDI «STALIN», Tiranë. TELEFONAT: Zëvendëskryeredaktori 78-13, sekretari i kolegjiumit 75-58, përgjegjësi i sektorit ideologjik 78-11, sektori ideologjik 78-14 dhe 78-07, përgjegjësi i sektorit ekonomik 78-10, sektori i ekonomisë 64-75, përgjegjësi i sektorit të jashtëm 78-08, sektori i fashitë 21-92, përgjegjësi i sektorit të brendshëm dhe i letrave 78-09, sektori i brendshëm dhe i letrave 33-87, sekretariati dhe shërbimi i natës 78-07, administrata dhe kartoteka 78-12, nëpunësi i rojës 30-84. PAJTIMET: për një vit 94,80 lekë, për 6 muaj 47,40 lekë. Për jashtë shtetit: 130 lekë për një vit, 70 lekë për 6 muaj